



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA  
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DP  
 Nr. l faq. 2 fage  
 Broj stranica  
 Nr. pages

Nr. Prot. 01.17307/11  
 Br. Prot. Prot No.  
 Data 10.10.2011  
 Datum Date

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

REKREK... REPUBLIKA KOSOVA  
 KOMUNA... VITISË... VITINA

10-10-2011

02-08/1799

Pranuar - Prillog	Shprehje - Prillog	Vlers - Vlednost
-------------------	--------------------	------------------

DATE/A:	06.10.2011
REFERENC-Ë:	AKK-DP
PËR/ZA/TO:	z. Rexhep Osmani Menagjer i Zyrës së Prokurimit Komuna e Vitisë-VES
CC:	z. Nexhmedin Arifi Kryetari Komunës së Vitisë.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Ndërtimi i kompleksit të varrezave të dëshmorëve në Viti".



I nderuar, z. Osmani

Duke u bazuar në nenin 19 pika 1.16 të Ligjit Nr. 04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik lidhur me tenderin "Ndërtimi i kompleksit të varrezave të dëshmorëve në Viti", me nr:657-11-065-521 në Komunën e Vitisë, ofron këtë:

**OPINIË**

Që ju si AK t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim në mënyre që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 03/L-241 të Prokurimit Publik të Kosovës.

**Arsyetim**

Zyra e prokurimit në Komunën e Vitisë, si autoritet kontraktues në dosjen e tenderit "punë" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 657-11-065-521 me titull "Ndërtimi i kompleksit të varrezave të dëshmorëve në Viti", në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të neni 6.4 i Dosjes së tenderit të Kërkesat mbi mundësit teknike dhe / ose



profesionale- ka kërkuar, veç tjerash, sigurimin e Planit Dinamik, të njëjtin e ka kërkuar edhe te Aneksi 6 - Kriteret për dhënien e kontratës.

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të pikës : numër 4 te rubrika kategoritë, ku ka paraparë: " Planin dinamik" pesha e këtij nën kriteri është 20 % të poentimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.03/L-241 të Prokurimit Publik dhe atë:

- Dispozitën e nenit 51 të LPP-së 03/L-241 dhe
- Dispozitën e nenit 52 të LPP-së 03/L-241.

Zyra e prokurimit në Komunën e Vitisë nuk ka respektuar edhe pjesën 5 të Udhëzimit Administrative 04/2011/KRPP të datës 19.05.2011 i cili udhëzim parasheh që - asnjë kriter në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik nuk mundë të përdoren si kritere për dhënien e kontratës.

*Me respekt*